



BASHKIA VLORE

ROMACTED

*Promovimi i qeverisjes së
mirë dhe fuqizimit Rom
në nivelin vendor*

PLANI VENDOR PËR INTEGRIMIN E PAKICAVE ROME DHE EGJIPTIANE 2019-2022

Bashkia Vlorë



Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



Zbatohet
nga Këshilli i Evropës





BASHKIA VLORE

ROMACTED

Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit Rom në nivelin vendor

PLANI VENDOR PËR INTEGRIMIN E PAKICAVE ROME DHE EGJIPTIANE 2019-2022

BASHKIA VLORE

Programi ROMACTED

Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit Rom në nivel vendor

**Një program i përbashkët i
Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës**

Koordinatorë vendore:

Fabiola Deliaj, Bashkia Vlorë

Ekspertë:

Elona Dhembo

Raimonda Duka

Irena Karagjozi

Brisilda Taco

Xhesika Korra

Redaktor:

Orsiola Kurti



Ky dokument është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.

Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës.

Të gjitha palët që janë të interesuara për ta riprodhuar apo përkthyer të plotë apo pjesërisht këtë dokument, inkurajohen ta bëjnë diçka të tillë me autorizimin paraprak të Programit ROMACTED (romacted@coe.int).

Dizajni dhe printimi: Gent Grafik

Publikuar prej Programit ROMACTED
Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë
Sheshi Skënderbej, Pallati i Kulturës
Kati i tretë, Tiranë, Shqipëri
www.coe-romacted.org

www.coe.al
www.ec.europa.eu

© Programi ROMACTED, Dhjetor 2020





Falënderime

“Plani Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022” i Bashkisë Vlorë, synon pakicat rome dhe egjiptiane dhe paraqet në mënyrë të detajuar e operacionale masat që do të zbatohen në kuadër të politikave të Bashkisë për fushat prioritare të planit. Plani vendor është mbështetur në strategjinë e zhvillimit vendor të Bashkisë Vlorë pas Ndarjes Administrative dhe Territoriale, Planin Kombëtar për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve (NAPIRE), planin e zhvillimit social në nivel vendor dhe planin afat-mesëm të buxhetit të bashkisë.

Hartimi i Planit Vendor është një përpjekje e përbashkët midis Bashkisë, institucioneve qendrore, lehtësuesve dhe grupeve vendore komunitare të pakicave kombëtare rome dhe egjiptiane (GKV) për të identifikuar dhe prioritetuar masat brenda burimeve financiare të vlefshme. Procesi i hartimit të planit vendor ka marrë kohën dhe vëmendjen e duhur nga Grupi Institucional i Punës krijuar posaçërisht për planin vendor, administrata e Bashkisë, ekspertëve dhe Grupet Komunitare Vendore.

Duke iu referuar angazhimeve të Bashkisë Vlorë në kuadrin e bashkëpunimit me Programin e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës ROMACTED, ne do të vazhdojmë të punojmë për të promovuar përfshirjen e pakicave rome dhe egjiptiane në nivel vendor, në ofrimin efektiv të shërbimeve ofruar nga institucioni ynë.

Bashkia Vlorë do të angazhojë fondet e veta dhe të kërkojë dhe të llojë aty ku nevojitet për financim të jashtëm, nga fondet e BE-së/ donatorë të tjerë, e gjithë kjo për të përmbushur detyrimet tona për të gjithë qytetarët e bashkisë, gjithashtu për komunitetet rome dhe egjiptiane.

Mirënjohje pafund për Programin ROMACTED, Zyren e Këshillit të Evropës në Shqipëri si zbatues dhe çdokujt për kontributin në këtë dokument të rëndësishëm.

Dritan LELI

Kryetar i Bashkisë Vlorë



LISTA E SHKURTIMEVE

BE	Bashkimi Evropian
BV	Bashkia Vlorë
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
DRSSh	Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore
DRShSSh	Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror
DShP	Drejtoria e Shëndetit Publik
GKV	Grupi Komunitar i Veprimit
INSTAT	Instituti i Statistikave të Republikës së Shqipërisë
KiE	Këshilli i Evropës
NJA	Njësi Administrative
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
QFP	Qendra e Formimit Profesional
R&E	Romë dhe Egjiptianë
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZVA	Zyra Vendore Arsimore
ZRPF	Zyra Rajonale e Punësimit dhe Formimit Profesional
ZVP	Zyra e Vendore e Punës



Pasqyra e Lëndës

FALËNDERIME	5
I. HYRJE	9
II. KUADRI LIGJOR DHE POLITIK	11
III. METODOLOGJIA ROMACTED, PROCESI DHE AKTORËT E PËRFSHIRË	14
IV. ANALIZA SITUACIONALE VENDORE	19
V. PAKICAT ROME DHE EGJIPTIANE NË BASHKINË VLORË DHE VLERËSIMI I NEVOJAVE	22
VI. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E PLANIT VENDOR	29
VI.1 VIZIONI	29
VI.2 OBJEKTIVAT E PLANIT VENDOR	29
VII. PLANI I MASAVE BASHKIA VLORË	30
VIII. BURIMET FINANCIARE	39
IX. MONITORIMI DHE VLERËSIMI	43
X. SHTOJCAT	45
X.1 MONITORIMI I PLANIT VENDOR PËR BASHKINË VLORË	45
X.2 KONSULTIME PUBLIKE MBI DRAFT PLANIN VENDOR	47
X.3 TASK-FORCA BASHKIAKE NË VLORË	48
X.4 VENDIM I KËSHILLIT BASHKIAK VLORË	49





I. Hyrje

“Plani Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022” është një dokument i Bashkisë Vlorë, i cili synon lehtësimin e procesve integruese për romët dhe egjiptianët në nivel vendor. Ai është mbështetur në “Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2016-2020”¹, një dokument politik i qeverisë shqiptare që adreson problematikat dhe çështjet kryesore që ndikojnë në jetën e pakicave rome dhe egjiptiane.

Dokumenti është mundësuar me mbështetjen e programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “ROMACTED: Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit Rom në nivelin vendor” përmes të cilit synohet të ndërtohet vullnet politik dhe angazhim i qëndrueshëm në nivel politikash vendore, për të përmirësuar qeverisjen demokratike dhe fuqizimin e romëve dhe egjiptianëve në Bashkinë Vlorë si dhe në gjashtë bashki të tjera të synuara në Shqipëri.

Ky dokument detajon planin e masave që synojnë integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane sipas pesë fushave prioritare:

Arsimi: Përmirësimi i situatës arsimore të romëve dhe egjiptianëve në Bashkinë Vlorë;

Punësimi dhe formimi profesional: Fuqizimi i pakicave rome dhe egjiptiane përmes rritjes së aksesit në tregun e punës, programeve të trajnimit dhe skemave të mbrojtjes sociale;

Kujdes Shëndetësor: Përmirësimi i qëndrueshëm i kushteve shëndetsore të romëve dhe egjiptianëve në Bashkinë Vlorë;

Strehimi: Përmirësimi i qëndrueshëm i kushteve të strehimit dhe infrastrukturës;

Kujdesi Social: Sigurimi i përfshirjes sociale dhe rritje e aksesit në institucionet publike;

Plani është produkt i një procesi, që i mundësoi grupeve në nevojë që jetojnë në këtë bashki mbështetje, duke i bërë ato pjesëmarrëse të drejtpërdrejta në vendimmarrje, nëpërmjet dizenjimit të aktiviteteve të planit të veprimit për zhvillim. Kjo bëhet më domethënëse dhe kuptimplotë kur plani i veprimit, synon specifikisht grupet në nevojë, të cilët jetojnë në kushte të vështira socio-ekonomike dhe janë të përjashtuar nga proceset vendimmarrëse që ndikojnë drejtpërdrejtë në jetët e tyre.

Bashkia Vlorë, si edhe bashki të tjera, sfidohet nga mungesa e informacionit rreth identifikimit të saktë të numrit të popullsisë rome dhe egjiptiane dhe kjo lidhet

1 (V)Vizioni dhe qëllimet Strategjike
(VI)Objektivat e Politikës



me dy faktorë : emigrimin (migrimin) dhe vetëdeklarimin e prejardhjes së tyre në gjendjen civile (e drejta e privatësisë dhe e drejta e vetëdeklarimit). Në këto kushte, edhe planifikimi vendor bëhet i vështirë për shkak të të dhënave sasiore të kufizuara. Procesi i vetëdeklarimit si romë dhe egjiptianë nuk është i standartizuar dhe disa struktura në nivel vendor hezitojnë të mbledhin këto të dhëna nga frika se mos dhunojnë të drejtat e privatësisë dhe të drejtën e vetëdeklarimit, që sanksionohet me ligj.

Ky dokument planifikimi synon, ndër të tjera, gjetjen e mekanizmave të rinj për mbledhjen e vazhdueshme të të dhënave për çështje që lidhen me mbrojtjen, fuqizimin dhe integrimin e tyre në pesë fushat e sipërpërmendura si më kryesoret për ta. Në këtë mënyrë, janë ata vetë që kontribuojnë në ndërtimin e kapaciteteve të fuqizimit duke pëmbledhur dhe analizuar të dhëna në lidhje me mirëqenien dhe qasjen në shërbime si dhe përfshirjen, hartimin dhe zbatimin në projekte konkrete publike për këto komunitete.

Nëpërmjet këtij plani do të krijohet një tablo e qartë e nevojave në lidhje me :

- Vizionin e së ardhmes dhe objektivat e planifikimit vendor për integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane;
- Planin e masave dhe monitorimin e tij në vijim, për sigurimin e zbatimit të masave duke deleguar dhe ndarë përgjegjësitë midis aktorëve kryesorë me afate të përcaktuara;
- Fuqizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve në komunitet;
- Orientimin dhe kanalizimin e vëmendjes dhe punës së administratës sipas pesë prioriteteve të fuqizimit të romëve dhe egjiptianëve;

Ky Plan Vendor i vjen në ndihmë anëtarëve të këtyre pakicave dhe komuniteteve vendore në tërësi si dhe autoriteteve vendore dhe rajonale të planifikojnë fuqizimin dhe integrimin e tyre në terma afat-mesëm, ndaj sa më gjithëpërfshirës procesi i planifikimit, aq më cilësore bëhen edhe proceset vendimmarrëse dhe politikëbërëse.



II. Kuadri ligjor dhe politik

Në Shqipëri, kuadri ligjor që garanton respektimin e të drejtave të pakicave ka themelet e tij në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, për të vazhduar me konventat ndërkombëtare dhe ligje, ku ndër të tjera përfshihen: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (Kombet e Bashkuara, 1948²), Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (1966), të ratifikuar në vitin 1991, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 1976 (1991), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës dhe Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare³, Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, 1980 (1996), Konventa për Nxitjen e Punësimit dhe Mbrojtjen nga Papunësia (nr.168 të ILO-s), 1988 (2006), Konventa kundër Diskriminimit në Arsim (1960), Konventa për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual (ligji nr. 10071/2009), etj.

Me miratimin dhe ratifikimin e konventave ndërkombëtare, pas viteve '90 qeveritë shqiptare kanë hartuar dhe miratuar ligje (dhe akte nën-ligjore) si dhe politika të tjera⁴ të cilat kanë krijuar premiset për një mjedis më mundësues për integrimin e pakicave në vend. Nga ana tjetër, edhe procesi i integritimit evropian i cili nuk përfaqëson vetëm një mundësi për vendin, por edhe një sfidë për sa i përket realizimit të reformave strukturore drejt statusit shtet anëtar i Bashkimit Evropian, ndikon në shtyrjen përpara edhe të proceseve integruese për pakicat.

Ndër dokumentet më të rëndësishëm në nivel kombëtar janë:

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020 dhe politikat sektoriale “Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA), Strategjia për Mbrojtjen Sociale janë fokusuar në (i) përmirësimin e përfshirjes sociale dhe aksesit në shërbimet bazë për personat dhe grupet e marginalizuara, (ii) ofrimin e programeve të specializuara, që lehtësojnë aksesin në tregun e punës dhe rrisin mundësitë e punësimit, (iii) ofrimin e mundësive për ndjekjen e arsimit

2 Miratuar në vitin 1955

3 Ligji Nr. 8496 / 1999

4 Ligje specifike të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt apo indirekt përfshijnë: ligji “Për avokatin e popullit” (8454/1999), ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (9887/2008), ligji “Për barazinë gjinore” (9970/2008), Kodi zgjedhor (2008), ligji “Për ndihmën juridike” (10039/2008), ligji “Për mbrojtjen nga të gjitha format e diskriminimit” (2010), ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e minoriteteve”, i ndryshuar (Ligji Nr. 96/2017), VKM-ja “Për arsimimin e komuniteteve minoritare në gjuhën e tyre amtare”, i ndryshuar, ligji për strehimin social (Ligji nr.22/2018), etj. Po kështu një sërë vendimesh të KM dhe dokumentesh politikë në këtë kuadër përfshijnë: Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) “Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Komitetit Shtetëror për Minoritetet”, i ndryshuar (VKM 726/12 Dhjetor 2018), Plani Kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit, i ndryshuar, Strategjia kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit rom, Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) dhe Dekada e Përfshirjes së Romëve, 2010 – 2015, PKV për Integrimin e Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, 2016-2020.



të detyrueshëm dhe të mesëm për personat, që kanë kaluar moshën e arsimit të detyrueshëm dhe që nuk e kanë përfunduar atë, (iv) Shtrirja e shërbimeve psikologjike, veçanërisht në shkollat ku ka fëmijë romë dhe egjiptianë dhe nxënës, që rrezikojnë të braktisin shkollën, (v) Lehtësimi i aksesit të grupeve vulnerabël në shërbimet shëndetësore përmes sigurimit të shërbimeve të shëndetit publik, ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik dhe i paketave të informacionit, si dhe i programeve specifike për aksesin në sistemin shëndetësor, ofrimi i mbështetjes nga punonjësit socialë dhe shërbimet e duhura shëndetësore, (vi) Krijimi i sistemeve të integruara të shërbimit në nivel rajonal/vendor, sipas standardeve të kujdesit për të gjitha grupet në nevojë nëpërmjet përmirësimit të mekanizmave kombëtarë dhe vendorë për identifikimin dhe vlerësimin e nevojës për shërbimet e kujdesit social në përputhje me procedurat standarde të veprimit dhe harmonizimin e legjislacionit shqiptar me kërkesat ndërkombëtare.

Masat e Planit Kombëtar të Veprimit (PKV) për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve (2016-2020) janë projektuar në gjashtë fusha prioritare: regjistrimi civil, arsimi dhe dialogu ndërkulturor, punësimi dhe zhvillimi i aftësive, kujdesi shëndetësor, strehimi dhe integrimi urban, si dhe mbrojtja sociale. Mbrojtja e të drejtave të njeriut, duke përfshirë romët, dhe politikat antidiskriminuese është një nga pesë prioritetet kyçe të agjendës për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Parimet kryesore të PKV-së për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve përfshijnë elemente si: (i) nxitja e përfshirjes sociale, (ii) masat për përgjigjen ndaj situatave të emergjencës, (iii) respektimi i dallimeve midis/dhe brenda këtyre komuniteteve, (iv) garantimi i përfshirjes së këtyre komuniteteve në projektimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave publike, (v) nxitja e bashkëpunimit midis aktorëve (qeverisja qendrore/dhe njësitë e qeverisjes vendore, OSHC-të dhe komunitetet).

Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (2015-2020), Reforma Territoriale Administrative (2015), Ligji për vetëqeverisjen vendore⁵, Ligji për financat publike vendore⁶ krijuan bazën dhe hapësirën për reformimin e mëtejshëm të njërive të qeverisjes vendore dhe riorganizimin administrativ të bashkive mbi bazën e ndarjes së re territoriale. Synimet strategjike janë të lidhur me: (i) rritjen e efciencës së strukturave të qeverisjes vendore, (ii) forcimi i financave vendore dhe decentralizimi fiskal, (iii) zhvillimi ekonomik vendor i qëndrueshëm dhe (iv) qeverisja e mirë në nivel vendor. Ligje të tjera të rëndësishme janë edhe Ligji 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe Ligji 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Në rrugën e saj drejt garantimit të qeverisjes së mirë, zhvillimit të qëndrueshëm dhe integritetit evropian, Shqipëria mbështetet edhe nga aktorë ndërkombëtarë, një prej të cilëve është Këshilli i Evropës.

5 Ligji 139/2015 Për Vetëqeverisjen Vendore

6 Ligji 68/2017 Për Financat Vendore



Në Shqipëri, aktivitetet e Këshillit të Evropës⁷ përqendrohen kryesisht në trajtimin e pengesave që mbajnë në vend të drejtat e pakicave, pavarësisht ecurisë në raport me angazhimet ligjore. Synimi i Këshillit të Evropës⁸ në lidhje me mbrojtjen e pakicave kombëtare është arritja e një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve të tij, me qëllim realizimin e parimeve dhe idealeve që përbëjnë trashëgiminë e tyre të përbashkët duke gjykuar se një prej metodave për arritjen e këtij qëllimi është ruajtja dhe realizimi i mëtejshëm i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Bazuar në këto konsiderata, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës ka miratuar “Deklaratën e Strasburgut”⁹ e cila ka për qëllim fuqizimin dhe promovimin e pjesëmarrjes efektive të romëve në jetën shoqërore, politike dhe qytetare, duke përfshirë pjesëmarrjen aktive të përfaqësuesve të romëve në proceset vendimmarrëse dhe përfshirjen sociale.

Një nga synimet e programit ROMACTED, i cili është vijueshmëri e programeve ROMED 2 dhe ROMACT, është hartimi i Planit të Veprimit në nivel vendor në shtatë bashki të përzgjedhura ¹⁰nëpërmjet 4 hapave kryesore: Përgatitja e procesit; Vlerësimi i nevojave dhe prioritizimi; Hartimi i planit të përbashkët të veprimit; Financimi, zbatimi dhe monitorimi. Këto hapa, zbatimi i tyre dhe rezultatet e arritura paraqiten në seksionet në vijim të këtij dokumenti.

7 Neni 4.2.4 Romët dhe Egjiptianët

8 Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare

9 Deklarata e Strasburgut mbi Romët

10 Bashkia Elbasan, Fier, Vlorë, Korçë, Përmet, Pogradec dhe Roskovec



III. Metodologjia ROMACTED, procesi dhe aktorët e përfshirë

Metodologjia dhe procesi i përshkruar për hartimin e këtij plani veprimi është konceptuar dhe zbatuar në një frymë të përgjithshme gjithëpërfshirëse. Kjo është mundësuar duke siguruar që çdo përpjekje e ndërmarrë në këtë kuadër të udhëhiqej nga parimet e fuqizimit, pjesëmarrjes dhe integritimit. Në punën me komunitetet në nevojë në përgjithësi, dhe në rastin konkret me pakicat rome dhe egjiptiane, besohet se fuqizimi apo mundësia për fuqizim të çdo individi është thelbësore për integrimin e gjithë komunitetit. Në këtë prizëm, adresimi i nevojave dhe problematikave përmes një modeli integruar, ku jetët e njerëzve dhe nevojat e tyre shihen, vlerësohen dhe mbështeten nga një këndvështrim multidisiplinar dhe shumëplanësh, kanë qenë në themel të përfaqësuesve. Ndryshimet, përmirësimet dhe arritjet mund të jenë të qëndrueshme veçse përmes një strategjie të tillë, ku përfaqësja e integruar nënkupton nevojën për koordinim dhe sinergji në fusha si arsimit, punësimi, përkujdesi shëndetësor, strehimi dhe shërbimet shoqërore.

Për arritje të qëndrueshme, gjatë të gjitha përpjekjeve të ndërmarrura u inkurajuan dhe zbatuan procese me pjesëmarrje. Pjesëmarrja e komuniteteve në të gjitha proceset i bën ato jo vetëm më të hapura, transparente dhe ndërvepruese, por shton shanset e suksesit dhe i bën rezultatet që vijnë prej tyre më të pranueshme dhe të zbatueshme nga komunitetet e synuara. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të pakicave rome dhe egjiptiane në çdo hap të konceptimit të këtij plani, siguroi, ndër të tjera, që edhe të dhënat dhe evidencat e mbledhura për të ushqyer hartimin e këtij plani të ishin të përditësuara dhe të përshtatshme. Ato e përforcuan më tej ndjesinë e pronësisë dhe përgjegjshmërisë për planin dhe zbatimin e tij.

Më konkretisht, procesi për hartimin e planit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në nivel vendor kaloi përmes katër hapave kyç, të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:



Tabela 1. Hapat e procesit për hartimin e "Plani Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022"

Hapi 1. Përgatitja e procesit dhe angazhimi	Hapi 2: Vlerësimi i nevojave dhe prioritizimi i tyre
<p>Detyrat e realizuara ishin:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Identifikimi i aktorëve – përgjatë të cilit iu dha përgjigje pyetjeve "Kush do të përfshihet?" "Pse? Ç'kontribute sjell?" b) Garantimi i angazhimit politik – mundësi identifikimin e aktorëve të vullnetshëm dhe çoi më tej dejt angazhimit të tyre politik për realizimin e procesit. c) Ngritja dhe mbështetja teknike për grupet dhe nën-grupet e punës për hartimin e planit. 	<p>Vlerësimi i nevojave të komunitetit kaloi përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Mbledhjes së të dhënave – këtu u përcaktuan burimet e të dhënave, teknikat për mbledhjen e tyre, si dhe indikatorëve/treguesve përkatës. b) Identifikimi dhe prioritizimi i problemeve dhe nevojave – me pjesëmarrjen e komuniteteve u identifikuan problematikat dhe nevojat e tyre si dhe u caktua se çfarë është më prioritar dhe e menjëhershme për adresim në kushtet e burimeve dhe kohës së kufizuar. c) Vlerësimi i kapaciteteve institucionale – ku iu dha përgjigje pyetjeve "Kush mund të bëjë çfarë për adresimin e problematikave/nejave të identifikuara?"
Hapi 3: Hartimi dhe miratimi i një Plani Veprimi të Përbashkët	Hapi 4: Financimi dhe zbatimi i projektit
<p>Hapi i tretë mundësi hartimin dhe miratimin e planit të përbashkët të veprimit dhe përfshiu reflektim dhe adresim të të mëposhtmeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Reflektim – Çfarë dimë nga procesi i vlerësimit të nevojave dhe prioritizimit të tyre? b) Ku synojmë të arrijmë? Ç'ndryshime duam të sjellim? c) Si? – aktivitete afatshkurtra & afatmesme. d) Integrimi i çështjeve rome në planin vendor – Si? Integrimi si pjesë e së tërës. Planet Sociale. e) Aktivitete/ndërrhyrje/ projekte konkrete – Çfarë? Kush? Kur? 	<p>Hapi i katërt ndërtoi rrugën drejt një plani të zbatueshëm, duke përfshirë çështje si financimi dhe monitorimi i tij. Gjatë këtij hapi iu dha përgjigje pyetjeve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Sa % e financimit të Planit Vendor do të mbulohet nga buxheti NJVQV-së? A parashikohen financime nga buxheti i shtetit? Donatorët? b) A ka hendek financiar? Cilat janë burimet e mundshme për financimin e projekteve të reja? c) Sa % e shpenzimeve të Planit Vendor janë të planifikuara në PBA-në 2019-2021? d) A kemi aktivitete/projekte të reja? Sa % të shpenzimeve zënë ato? Si planifikohet financimi i tyre? e) A është hendeku financiar pjesë e kërkesave buxhetore shtesë dhe bisedimeve me donatorë të ndryshëm?



Me qëllim vlerësimin e nevojave dhe informimin e proceseve vendimmarrëse lidhur me planin përmes të dhënave dhe evidencave u hartua dhe u zbatua një udhëzues për mbledhjen e të dhënave parësore dhe dytësore. Ato përfshinë burime të ndryshme, të përmbledhura në skemën ilustruese më poshtë.




Tabela 2. Burimet parësore dhe dytësore të të dhënave të përdorura

Burimet parësore:

Për përmbledhjen e të dhënave parësore përmes teknikave me pjesëmarrjen e komunitetit, u përdorën ushtrime të ndryshme dhe instrumenta metodologjikë të ndryshëm. Konkretisht, në Bashkinë Vlorë, për identifikimin dhe prioritarizimin e nevojave u përdorën ushtrime dhe teknika të tilla si: hartëzimi i nevojave dhe burimeve, intervista individuale dhe diskutime në grupe (të shoqëruara me vizita dhe vëzhgime në terren), ushtrime për zbërthimin e problematikave si “Matrica e problemit”, “Matrica me renditje dhe pikëzim”, “Panairi i ideve” etj.





Figura 1. Takim me Grupin Komunitar të Veprimit mbi procesin e hartimit të Planit Vendor




Figura 2. Takim me Grupin Komunitar të Veprimit dhe Grupin Institucional të Punës mbi prioritizimin e nevojave



Figura 3. Ushtrimi “Matrica me renditje dhe pikëzim”





Figura 4. Vëzhgime në terren mbi vlerësimin e nevojave

Të dhënat parësore u mblodhën edhe nga Bashkia Vlorë, veçanërisht në raport me kapacitetet institucionale në funksion të planit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve.

Burimet dytësore:

Burimet dytësore që u përdorën për hartimin e “Planit Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022” janë publikime, raporte zyrtare, dokumente qeveritare të institucioneve në nivel qendror, drejtori rajonale, vendore dhe zyrat e Bashkisë Vlorë, të cilat u përdorën në veçanti gjatë hartimit të Planit të Masave.



IV. Analiza situacionale vendore

Bashkia Vlorë formën që ka sot e mori pas reformës së qeverisjes vendore në vitin 2015, ku qytetit të Vlorës iu bashkuan edhe ish-komunat: Novoselë, Orikum, Komuna Qendër, dhe Shushicë. Në total, popullsia e Bashkisë Vlorë është rreth 195,827 banorë, në një sipërfaqe totale prej 617 kilometra katrorë. Bashkia Vlorë shtrihet nga lumi Vjosa pranë Novoselës deri në Llogara, përfshirë qytetin e Orikut me më shumë se 90 km vijë bregdetare.



Struktura aktuale bashkiake është miratuar në korrik të vitit 2015, pas zgjedhjeve vendore, me hyrjen në fuqi të ndarjes territoriale. Në strukturën aktuale të Bashkisë së Vlorës ka një staf prej 955 persona, nga të cilët 462 anëtarë stafi janë për ushtrimin e funksioneve të deleguara.

Në Bashkinë e Vlorës veprojnë më shumë se 4,500 biznese dhe të ardhurat nga këto biznese përbëjnë dhe zërin kryesor në buxhetin e bashkisë. Ato ofrojnë shërbime për më shumë se 150,000 banorë në dimër dhe më shumë se 300,000 në verë.

Vlora është një qendër e rëndësishme tregtare dhe detare në Shqipëri, ku veçanërisht e zhvilluar është industria e peshkimit. Vlora prodhon naftë, gaz natyror, bitum dhe kripë. Po kështu, e zhvilluar në qytet është edhe industria e manufakturës tekstile si dhe ajo e ndërtimit.



Elementë të fortë të zhvillimit ekonomik dhe social të kësaj bashkie janë:

- Pozita gjeografike - Vendndodhja në raport me detin, lartësinë, lagunën, faunën, florën, pyllin.
- 2. 90 km vijë bregdeti, rërë dhe plazhe shkëmbore
- Afërsia me Tiranën (kryeqytet), Italinë & Greqinë.
- Kushtet e favorshme për turizmin rural, laguna dhe kulturat bujqësore e produktet blegtorale.
- Objektet kulturore, historike dhe arkeologjike.
- Lartësi të përshtatshme për zhvillimin e aeronautikës në Llogara dhe Shushicë.
- Produktet vendase të detit dhe tokës - peshk, vaj ulliri, mjaltë, verë, etj.
- Marrëdhëniet midis komuniteteve/pakicave dhe diversitetin fetar.
- Peizazhe të paprekura, vende dhe zona natyrore.

Vitet e fundit ka pasur një zhvillim të madh turizmi për shkak të bukurive natyrore duke u shoqëruar ky zhvillim me ndërtimin e shumë hoteleve, restoranteve, plazheve.

Spektori i turizmit është një fushë prioritare në fokusin e Bashkisë së Vlorës për shkak të kontributit të tij të rëndësishëm për rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës, si dhe rritjen e njohurive dhe vetëdijes kulturore midis vendeve.

Bashkia Vlorë ka zgjedhur turizmin si një sektor kryesor dhe si një katalizator të rritjes ekonomike. Kjo zgjedhje është mbështetur nga një numër i lartë i investimeve private dhe publike në aktivitetet e turizmit, kryesisht në strukturat akomoduese. Janë 3 prioritetet kryesore që bashkia parashikon për zhvillimin ekonomik të zonës:

- Përmirësimin e infrastrukturës - veçanërisht rregullimi dhe mirërregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve;
- Stimulimin dhe rritjen e sektorit privat dhe ndërmarrjet publike;
- Përmirësimin e cilësisë së produkteve vendore dhe promovimin e tyre për turistët dhe tregjet jashtë vendit.

Për sa i përket kujdesit social në këtë bashki, ai fokusohet tek individi me qëllim zhvillimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në mënyrë që grupet në nevojë të përfshihen në programe të ndryshme, që inkurajojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të këtyre grupeve në shoqëri. Shërbimet e kujdesit social luajnë një rol



kyç në përmirësimin e cilësisë së jetesës të individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë.

Një element i rëndësishëm i zhvillimit social është ndërtimi i shërbimeve për fuqizimin e personave në nevojë (veçanërisht të rinjve të pakicave romë dhe egjiptiane, nëpërmjet shërbimit të ndërmjetësimit në bashki për punësimin e tyre si dhe ofrimin e programeve të formimit profesional pranë NJA-ve në bashkëpunim me ZRPPF, si dhe në përshtatje me tipologjinë e punësimit në zonat rurale dhe ato turistike.

Bashkia Vlorë do të zbatojë vullnetin e saj për të ofruar dhe garantuar mbrojtje dhe zhvillim qytetarëve të Vlorës që i përkasin grupeve në nevojë, në frymën e re të ligjit për shërbimet e sociale. Shërbimet e Kujdesit Social u jepen grupeve në nevojë në nivel bashkie përmes përfshirjes së njësive të referimit për vlerësimin e nevojave, njësive për mbrojtjen e fëmijëve, ndërmarrjeve sociale, qendrave shumëfunktionale, të ngritura sipas kërkesave të ligjit. Fondi Social pritet të zbatohet në nivel vendor bazuar në Planin Social të hartuar dhe miratuar nga Bashkia.



V. Pakicat rome dhe egjiptiane në Bashkinë Vlorë dhe vlerësimi i nevojave

Në bashkinë Vlorë edhe në njësitë administrative Novoselë, Shushicë dhe Qendër, sipas të dhënave të mbledhura në terren rezultojnë 1.200 banorë të pakicave rome dhe egjiptiane, ose 6.06% e popullsisë vendase. Niveli i varfërisë të këtyre komuniteteve është 90% (1.080 persona). Brenda të njëjtës familje ose shtëpi mund të jetojnë 2 ose tri kurora dhe kushtet e jetesës janë shumë të vështira duke marrë parasysh papunësinë e madhe që ekziston në zonat ku janë kryesisht të vendosura këto pakica. Në përgjithësi, situata ekonomike e romëve dhe egjiptianëve dhe kushtet e jetesës së tyre janë në nivele tepër të ulta si dhe në kushte strehimi dhe shëndetësore mjaft problematike¹¹.

Në analizën tonë sipas fushave prioritare, për situatën e pakicave R&E vërejmë si vijon:

ARSIM: Ka një sërë faktorësh që ndikojnë në pengesat që hasin prindërit romë në lidhje me arsimimin e fëmijëve të tyre, por kryesore janë varfëria dhe mungesa e mundësive financiare për mbështetjen e shkollimit. Të tjerë faktorë pengues që hasin vetë fëmijët e pakicave rome dhe egjiptiane janë: mungesa e theksuar e interesit për vazhdimin e shkollës, punësimi i fëmijëve me qëllim për të kontribuar në të ardhurat e familjes si dhe arsimimi i ulët i prindërve të tyre.

Parë në këndvështrimin gjinor, praktika e martesave të hershme të vajzave dhe përforcimi i roleve tradicionale gjinore në lidhje me përkujdesjen familjare dhe punët e shtëpisë, rrit akoma më shumë hendekun gjinor në arsim. Për aq kohë sa pjesa më e madhe e këtij komuniteti jeton në varfëri ekstreme, duke u përballur në mënyrë të vazhdueshme me përjashtimin social, hezitimi për të kërkuar të drejtat do të vazhdojë të mbizotërojë ndjeshëm tek ky komunitet. Sipas të dhënave nga DAR Vlorë, në të gjithë bashkinë duke përfshirë të gjitha njësitë administrative të saj janë:

- Pakicat rome: 24 fëmijë që frekuentojnë kopshtet, 55 fëmijë që ndjekin ciklin fillor, 38 fëmijë që ndjekin ciklin 9-vjeçar dhe 11 të rinj që ndjekin shkollat e mesme.
- Pakicat egjiptiane: 148 fëmijë që frekuentojnë kopshtet, 368 fëmijë që ndjekin ciklin fillor dhe 356 fëmijë që ndjekin ciklin 9-vjeçar, si dhe 84 të rinj që ndjekin shkollat e mesme.

11 Të dhëna prej shoqatave rome



Në Bashkinë Vlorë gjenden 19 kopshte, 18 shkolla 9-vjeçare dhe 8 shkolla të mesme. Ato frekuentohen nga një numër i konsiderueshëm fëmijësh nga pakicat R&E, megjithatë vetë vlerësimi i nevojave të tyre bëhet i vështitë në kushtet kur nuk ka të dhëna statistikore në fushën e edukimit, që të mundësojnë analizat rreth gjendjes arsimore të fëmijëve romë dhe egjiptianë në këtë bashki.

Megjithatë, një sërë problematikash janë identifikuar në raport me çështjet e arsimit. E para lidhet me infrastrukturën e shkollave dhe kopshteve të cilat raportohen të kenë një sistem ngrohjeje jo funksional për shkak të amortizimit të trupave të kaldajave dhe instalimeve të dobëta elektrike. Edhe pse kjo është një problematikë që i prek të gjithë fëmijët, fëmijët nga familje të varfëra e kanë edhe më të vështirë duke pasur në konsideratë problematika të keqshqyerjes, mungesës së veshjeve të përshtatshme apo problemeve me shëndetin.

Nga ana tjetër, raportohen një sërë mangësish në aktivitetet shkollore si mungesa e veprimtarive edukative individuale për zhvillimin gjuhësor të fëmijëve që hasin vështirësi në komunikimin në gjuhën shqipe; mungesa e orëve shtesë në lëndë të ndryshme në përputhje me nevojat e fëmijëve romë dhe egjiptianë për të siguruar ecurinë e tyre normale në shkollë etj.

Po kështu pak ose aspak bëhet për ndërgjegjësimin dhe afrimin e prindërve me shkollën. Nuk ka organizim të aktiviteteve sociale e kulturore me prindër /nxënës romë dhe egjiptianë me ata që i përkasin shumicës së popullsisë me qëllim rritjen e njohurive dhe mirëkuptimit midis fëmijëve të këtyre pakicave dhe atyre të tjerë. Gjithashtu, mungojnë organizimet e fushatave ndërgjegjësuese dhe aktiviteteve me karakter informues për rreziqe dhe pasojat e trafikimit, edukimit mjedisor dhe një sërë aktiviteteve të tjera me karakter informues.

Së fundmi, por jo për nga rëndësia, raportohet se mbështetja në sigurimin e teksteve dhe mjeteve shkollore falas për fëmijët romë dhe egjiptianë që ndjekin arsimin e detyruar dhe vijnë nga familjet e varfëra nuk ka qenë e vijueshme.

PUNËSIM: Si rezultat i shkallës së ulët të nivelit arsimor, varfërisë dhe përjashtimit social, romët dhe egjiptianët kanë një shkallë më të lartë papunësie, në raport me shumicën. Edhe pse Strategjia e Shërbimeve Sociale, nënvizon favorizimin e ndërmarrjeve sociale, ku 30 për qind e punonjësve të punësuar në ndërmarrjet sociale duhet t'i përkasin kategorisë së grupeve të pafavorizuara nga pikëpamja sociale dhe ekonomike sikurse janë romët dhe egjiptianët, janë shumë të pakët bizneset që kanë punësuar romë dhe egjiptianë në Bashkinë Vlorë.

Këto biznese i punësojnë romët dhe egjiptianët kryesisht në aktivitete si fasoneri, industri mekanike, industri plastike, industri ushqimore dhe riciklim. Edhe pse nuk ka të dhëna të sakta për tipologjinë e bizneseve që kanë punësuar anëtarë të këtyre dy pakicave, vlen të theksohen aftësitë karakterizuese në zanate tradicionale si punime me thupra, zeytari, muzikë, hekurpunues etj.

Krahas hezitimit për shkak të arsimit të ulët apo moshës relativisht të lartë për



t'u punësuar, të intervistuarit në terren shprehen për mungesën e informacionit lidhur me procedurat dhe aplikimin, si dhe mungesën e besimit të zyrat e punës. Ajo çfarë shqetëson tjetër këto pakica ka të bëjë gjithashtu me mundësitë shumë të pakta për punësim në tregun formal të punës.

Ekzistojnë disa programe punësimi të cilat kanë për qëllim nxitjen e punësimit të grupeve në nevojë dhe janë të dobishme dhe të shfrytëzueshme edhe prej pakicave romë dhe egjiptiane, të cilët kategorizohen si grupe të veçanta për të përfituar nga këto programe si kuzhinë, elektrikë, autoservis, hidraulikë, panele diellore, saldatorë, parukeri, estetikë, rrobaqepsi etj.

Në Bashkinë Vlorë papunësia dhe vështirësitë ekonomike kanë çuar drejt emigrimit në shkallë të gjerë. Kjo situatë është shoqëruar me probleme sociale komplekse për familjen, me probleme të regjistrimit të fëmijëve, dhe shkallë të lartë ndarjesh dhe divorcesh në familje. Situata social-ekonomike e këtyre individëve dhe familjeve të tyre vështirësohet më tej si nga mungesa e vendeve të punës ashtu edhe nga mungesa e informimit mbi mundësitë e punësimit.

Përfaqësuesit e pakicave romë dhe egjiptiane raportojnë për një sërë mungesash në kuadër të punësimit si: mungesa në organizimin e fushatave informuese me të papunët R&E të regjistruar apo të paregjistruar si punëkërkuar, mbi mundësitë dhe përfitimet nga programet e punësimit; mungesë financimi të programeve dhe projekteve të zhvillimit ekonomik dhe punësimit që u mundësojnë R&E të dalin nga kushtet e varfërisë; mungesë të ofrimit të kurseve profesionale për të rinjtë R&E në punë tradicionale e artizanale (dhe jo vetëm) dhe i fushatave informuese mbi të drejtat dhe detyrimet e R&E në fushën e punësimit.

Për adresimin e problematikave të punësimit nevojitet integrim më efikas i komunitetit R&E në edukimin e përgjithshëm publik dhe trajtimin profesional.

KUJDES SOCIAL: Romët dhe egjiptianët në Bashkinë Vlorë përbëjnë dy pakica, të cilat përballen me mungesën e një punësimi konstant formal dhe rrjedhimisht me të ardhura ekstremisht të ulta për të siguruar mbijetesën e tyre. Nga ana tjetër, ata përballen gjithashtu me një përjashtim të lartë nga përfitimi i ndihmës dhe skemave sociale. Për shkak të burimeve të kufizuara të të ardhurave kryesisht në sektorin informal dhe varfërisë ekstreme, shumë familje romë dhe egjiptiane e shohin ndihmën ekonomike si të vetmin burim alternativ të të ardhurave.

Sipas sistemit RomAlb janë 467 romë dhe egjiptianë, të cilët përfitojnë ndihmën ekonomike në Bashkinë Vlorë.

Një pjesë e konsiderueshme e anëtarëve të pakicave romë dhe egjiptiane nuk e përfitojnë ndihmën ekonomike pasi kanë mangësi në dorëzimin e dokumenteve dhe sidomos me procedurën e re të sistemit me pikëzim. Ata nuk regjistrohen dot si të papunë dhe nuk sigurojnë dot vërtetimin apo çertifikatën pasi nuk janë të regjistruar në zyrën e gjendjes civile dhe nuk pasqyrojnë dot në dokumentet ligjore ndryshimet familjare për shkak të divorcit, migrimit, neglizhencës etj.



Përpos nivelit të ulët arsimor të komunitetit rom dhe egjiptian, për të kuptuar programe të tilla dhe rrjedhimisht për të përfituar nga këto programe, një pjesë e konsiderueshme e të intervistuarve në terrenin e Bashkisë Vlorë dhe njësisë administrative shprehen se ka një mungesë gatishmërie edhe nga ana e stafit të institucioneve për të ndihmuar/orientuar në plotësimin/dorëzimin e dokumentave për përfitimin e shërbimeve të tilla.

Ndonëse ka të dhëna lidhur me përfituesit e NE nga pakicat R&E mungon një bazë të dhënash për identifikimin e të gjithë R&E për të mundësuar përcaktimin e nevojave dhe nivelit të përmbushjes së tyre përmes shërbimeve shoqërore. Të dhëna sistematike nevojiten të grumbullohen edhe lidhur me problematika specifike si dhuna në familje, rastet e shfrytëzimit të punës së fëmijëve R&E, etj.

Në adresimin e këtyre problematikave lipset një përqsasje më proaktive si: identifikimi, parandalimi dhe zgjidhja e konflikteve brenda familjeve dhe atyre që mund të shkaktojnë dhunë edhe në komunitet; identifikimi dhe monitorimi i rasteve të fëmijëve që shfrytëzohen; ofrimi i programeve të edukimit ligjor për anëtarët e komuniteteve R&E që synojnë rritjen e njohurive të tyre mbi të drejtat e njeriut; fushata sensibilizuese me anëtarët e komunitetit R&E rreth të drejtave në lidhje me skemën e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë dhe ndihma ekonomike për personat me aftësi të kufizuara; ofrimi i shërbimeve mbështetëse dhe informacion për sipërmarrësit R&E mbi zhvillimin e planeve të biznesit, kontabilitetit, procedurat ligjore dhe marketingun.

STREHIM: Një ndër problemet më të mëdha me të cilën përballen anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane ka të bëjë me vendbanimet e papërshtatshme dhe të pasigurta ku ata jetojnë si edhe aksesit shumë i ulët në programet sociale të strehimit. Mospasja e një strehimi të sigurt kushtëzton ndjeshëm cilësinë e jetës në të gjitha fushat e tjera.

Në zonat ku ka një shumicë të popullsisë rome dhe egjiptiane ka probleme shqetësuese jo vetëm me informalitetin e banesave, por gjithashtu në lidhje me infrastrukturën rrugore, ndriçimin, furnizimin me ujë të pijshëm, kanalizimin e ujrave të zeza, probleme të cilat ndikojnë ndjeshëm në cilësinë e jetesës së këtyre familjeve. Edhe pse programet e strehimit synojnë të adresojnë grupet e pafavorizuara, të cilat kanë të ardhura të ulta¹², romët dhe egjiptianët përfitojnë në një masë shumë të ulët nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit¹³. Megjithë përpjekjet e autoriteteve qendrore e vendore, ka mjaftueshëm raste kur i njëjti sistem i përjashton ata për shkak të mospajisjes me dokumentacionin e nevojshëm (legalizimet).

Duke marrë parasysh nivelin e ulët të arsimimit të anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane, njohuritë e ulta për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm,

12 Ligji nr 22/2018 "Për strehimin social"

13 Vendim i KM nr 405, datë 1.6.2016 Për Miratimin e Strategjisë së Strehimit Social 2016-2025

edhe pse favorizohen nga sistemi, u heqin të drejtën përfituesve të mundshëm për t'u trajtuar me : a) banesë sociale me qira, të cilat mund të jenë ndërtim i ri ose adaptim i objekteve ekzistuese b) pajisje e truallit me infrastrukturë, ku familjet të ndërtojnë vetë banesën e tyre me mbështetje të bashkive dhe/ose shoqatave, c) përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara, banesë sociale me qera apo kosto të ulët¹⁴.

Familjet rome dhe egjiptiane janë relativisht të mëdha në numër dhe mosndarja nga trugu familjar përbën një pengesë për të mos përfituar nga banesat sociale, pasi standardet e vendosura nuk lejojnë më shumë se 12 m² për frymë. Në bashkinë e Vlorës familjet rome dhe egjiptiane mund të përfitojnë nga sistemi i donusit të strehimit, i cili parashikon mbulimin e qerasë në masën 50%. Gjithsesi, duke marrë parasysh që shumë kontrata të qirave nuk janë të noterizuara këto familje nuk i përbushin kriteret për të përfituar nga kjo skemë.

Në bashkëpunim me zyrën vendore të Planifikimit Urban dhe zyrën e Strehimit në Bashkinë Vlorë, përgjatë zbatimit të programit ROMACTED, u hartuan 42 projekte dhe preventiva për rikonstruksion shtëpish të familjeve në nevojë të R&E në njësitë administrative Novoselë dhe Shushicë, drejtuar Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Drejtorisë së Strehimit mbi thirrjen e projekteve të strehimit për vitin 2019.

Mospasja e një strehimi të sigurt kushtëzon ndjeshëm cilësinë e jetës në të gjitha fushat e tjera. Në zonat ku ka një shumicë rome dhe egjiptiane ka probleme shqetësuese jo vetëm me informalitetin e banesave, por gjithashtu edhe me infrastrukturën rrugore, ndriçimin, furnizimin me ujë të pijshëm, kanalizimin e ujrave të zeza, probleme të cilat ndikojnë ndjeshëm në cilësinë e jetesës së këtyre familjeve. Për lehtësimin e kësaj situatë në Bashkinë Vlorë ka nevojë pikë së pari për një përditësim të vlerësimit të nevojave për strehim (ndërtim banese, rikonstruksion banese, rregullime të infrastrukturës bazë) në të gjitha njësitë administrative(4) ku banojnë pakicat rome dhe egjiptiane.

Në kuadër të vlerësimit të nevojave në kuadër të hartimit të këtij plani rezultoi se ka nevojë prioritare për: rikonstruksionin e banesave në njësitë administrative Novoselë dhe Shushicë (rikonstruksione, çati, dyer, dritare, suvatime etj); ndërhyrje të menjëhershme për përmirësimin e kushteve të ujësjellësit (cilësia e ujit të pijshëm) dhe kanalizimeve në zonat e Novoselës dhe Shushicës; ndërhyrje e menjëhershme për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, në rrugën dytësore Akërn-Novoselë.

Zbatimi i programeve vendore të strehimit social kërkohet të ketë një vëmendje të shtuar për familjet R&E (banesa sociale me qera; banesa me kosto të ulët, shitja e truallit të pajisur me infrastrukturë dhe lejes së ndërtimit për ndërtim shtëpish). Konstatohet një mungesë e trajtimit me prioritet të kërkesave të komunitetit rom

14 <https://financa.gov.al/drejtoria-e-strehimit/Shotjca“A”> (Shkresa nr. 604, datë, 15.01.2019)



dhe egjiptian për zgjidhjen e çështjeve të legalizimit përmes zbatimit të legjislacionit përkatës, gjë që kërkon vullnet dhe vijueshmëri përpjekjesh për adresim.

KUJDES SHËNDETËSOR: Situata shëndetësore e romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri priret të jetë përgjithësisht më e përkeqësuar krahasuar me popullsinë në shumicë. Romët kanë një jetëgjatësi mesatare të paktën 10 vite më të ulët se popullsia shumicë dhe kanë një shkallë të lartë të vdekshmërisë foshnjore¹⁵. Në përgjithësi romët karakterizohen nga një incidencë më e lartë sëmundshmërie dhe janë më të prekshëm sidomos ndaj sëmundjeve të transmetueshme¹⁶ për shkak të vendbanimeve të tyre dhe jetës nomade që bëjnë.

Edhe pse aksesit në shërbimin shëndetësor parësor ofrohet falas në të gjitha qendrat shëndetësore¹⁷, këto pakica kanë një akses shumë të ulët në shërbimin e kujdesit parësor dhe atë të specialiteteve. Shpesh herë kjo rezulton edhe për shkak të stilit të tyre të jetesës jo të shëndetshme dhe kushteve sociale ekonomike të cilat favorizojnë sëmundjet kronike.

Ka një sërë faktorësh që ndikojnë në degradimin e gjendjes së tyre shëndetësore, duke përfshirë këtu kushtet e papërshtatshme të jetesës, dieta e varfër ushqimore, mungesa e aksesit ndaj shërbimeve shëndetësore, mungesa e informacionit kundrejt shërbimeve shëndetësore dhe mbi të gjitha varfëria ekstreme dhe niveli i lartë i ekspozimit ndaj kushteve ekstremisht të pasigurta të banesave të tyre.

Në fushën e shëndetësisë përgjegjësia e njërive të qeverisjes vendore shtrihet vetëm në mirëmbajtjen e infrastrukturës së shërbimit të kujdesit parësor. Në nivel qarku, në Vlorë funksionojnë 200 qendra shëndetësore të cilat janë bazuar në “Paketën Bazë të Shërbimeve në Kujdesin Shëndetësor Parësor”, të aprovuar nga Ministria e Shëndetësisë në janar 2009. Ato ofrojnë për të gjithë personat e siguruar shërbime të tilla si: kujdesin në rastet e urgjencës; kujdesin shëndetësor për mirërritjen e fëmijëve; kujdesin shëndetësor për gratë dhe shëndetin riprodhues; kujdesin shëndetësor për të rriturit; kujdesin shëndetësor për të moshuarit; kujdesin shëndetësor mendor; promocionin dhe edukimin shëndetësor. Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Vlorë është institucioni kryesor i cili mbulon këtë fushë. Momentalisht, shërbimi shëndetësor pranë mjekut të familjes ofrohet falas si për personat e pa siguruar dhe ata të siguruar, por niveli i aksesit varjon.

Gjatë vlerësimit të nevojave në këtë fushë u evidentua se ka mungesë të fushatave ndërgjegjësuese me gratë dhe vajzat (veçanërisht në N.J.A Shushicë, Novoselë dhe Qendër) mbi shëndetin riprodhues, të tilla si planifikimi familjar, kujdesi për shtatëzanitë dhe për fëmijët e porsalindur, shëndeti i gruas etj; nevojiten fushata ndërgjegjësuese dhe edukative për mbrojtjen nga HIV, AIDS; ka nevojë

15 Komisioni Evropian, Raport mbi shëndetin e komunitetit rom: Gjendja shëndetësore e popullsisë rome dhe monitorimi i të dhënave të mbledhura në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, prill 2014,

16 Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë Shqiptare 2016-2020 http://www.shendetesia.gov.al/files/userfiles/draft_strategjia/Draft_Strategjia_30Maj2016_web.pdf, aksesuar me 18.07.2017; Gëdeshi& Miluka, 2012 58.

17 Urdhëri nr 28, datë 26.01.2016 Për sistemin e referimit dhe tarifave të shërbimit shëndetësor publik



për zbatimin e programeve ndërgjegjësuere dhe edukative për rëndësinë dhe mënyrën e ruajtjes të higjienës personale në zonat e banuara kryesisht prej R&E; nevojiten më shumë fushata informuese me pakicat rome dhe egjiptiane rreth dokumentacionit dhe procedurave për të përfituar shërbime shëndetësore të të gjithë kategorive si dhe fushatave për vaksinimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë, të cilët rrezikojnë të mos kenë marrë të gjitha vaksinat.

Pika të forta dhe pika të dobëta të pakicave rome dhe egjiptiane në Bashkinë Vlorë

Bazuar në vlerësimin e nevojave të pakicave R&E në Bashkinë Vlorë u evidentuan një sërë problematikash. Ato rezultojë si pasojë e një sërë faktorësh, ku me rëndësi janë edhe pikat e dobëta të vetë këtyre komuniteteve. Nga ana tjetër, njohja e tyre dhe evidentimi i pikave të forta të pakicave R&E krijon mundësi për adresimin e dobësive dhe shfrytëzimin e kapaciteteve ekzistuese për një adresim sa më efikas të problematikave të identifikuara. Në analizën e realizuar me pjesëmarrjen e anëtarëve të pakicave R&E u identifikuan një sërë pikash të forta dhe të dobëta, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2. Pikat e forta dhe pikat e dobëta ndër pakicat R&E, Bashkia Vlorë

Pika të forta:	Pika të dobëta:
<ol style="list-style-type: none"> 1. Ruajtja e mirë e gjuhës dhe e traditave; 2. Jetesa në harmoni brenda komunitetit të tyre si edhe me pakica të tjera, si ajo greke në Vlorë dhe me pjesën tjetër të popullsisë më gjerë; 3. Dashamirësia për punën dhe veçanërisht artin, jo vetëm si pasion, por edhe si profesion të zhvilluar dhe trashëguar; 4. Potencialet humane të komunitetit, veçanërisht e talenteve të rinj në muzikë; 5. Përgjithësisht fëmijët e këtyre pakicave janë arsimdashës dhe e ndjekin në pjesën më të madhe shkollën, pavarësisht kushteve infrastrukturore dhe vështirësive familjare ekonomike; 6. Një ndjenjë e fortë e përkatësisë dhe identitetit; 7. Zejtarë shumë të mirë në prodhimin e shportave, punimit të hekurit etj. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pakicat rome dhe egjiptiane në këtë zonë janë prekur ndjeshëm prej emigrimit dhe një pjesë e familjeve jetojnë të ndara. Ata kanë probleme të përkujdesjes dhe kujdestarisë ndaj të miturve; 2. Mungesë njohurish dhe aftësish për të përdorur faqet zyrtare ueb të Bashkisë ose faqe të tjera për t'u informuar. Ata ndeshin vështirësi në kuptimin e termave financiarë dhe terminologjisë në përgjithësi; 3. Mungesë interesi për të marrë pjesë në takimet e Këshillit Bashkiak ku diskutohen tema që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik-social në përgjithësi dhe që prekin drejtpërdrejt pakicat në veçanti.



VI. Vizioni dhe objektivat e Planit Vendor

VI.1 Vizioni:

Në katër vitet e ardhshme, romët dhe egjiptianët në Bashkinë Vlorë nuk kanë kufizime në aksesimin e shërbimeve publike duke garantuar shëndet më të mirë, arsimim të plotë, dhe rritje të mirëqenies nëpërmjet punësimit formal drejt integritimit të plotë të këtyre pakicave në shoqërinë vendore.

Objektiva strategjike:

Arsimi:

Përmirësimi i situatës arsimore të romëve dhe egjiptianëve në Bashkinë Vlorë;

Punësimi dhe formimi profesional:

Fuqizimi i pakicave rome dhe egjiptiane përmes rritjes së aksesit në tregun e punës, programeve të trajnimit dhe skemave të mbrojtjes sociale;

Kujdes Shëndetësor:

Përmirësimi i qëndrueshëm i kushteve shëndetsore të romëve dhe egjiptianëve në Bashkinë Vlorë;

Strehimi:

Përmirësimi i qëndrueshëm i kushteve të strehimit dhe infrastrukturës;

Kujdesi Social:

Sigurimi i përfshirjes sociale dhe rritje e aksesit në institucionet publike;

VII. Plani i masave, Bashkia Vlorë

Fusha e ndërhyrjes: ARSIMI						
1.1. Objektiv i specifik: Përmirësimi i situatës arsimore të pakicave rome dhe egjiptiane						
Masa/aktiviteti	Aktorët	Treguesit e rezultateve	Burimet e të dhënave	Afatet	Fondet/Financimi (lekë)	Monitorimi
1.1.1 Krijimi dhe /ose përmirësimi i të dhënave statistikore në fushën e edukimit që të mundësojnë analizat rreth gjendjes arsimore të fëmijëve R&E në BV.	Bashkia Vlorë DAR Vlorë	Krijimi i databazave që sigurojnë të dhëna për arsimimin e pakicave R&E	Informacion nga Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë	2019-2022	271,040	BV DRShSSH
1.1.2 Përmirësimi i sistemit të ngrohjes në 3 shkolla 9-vjeçare: "Faslli Danaj"-Llakatund, "Pilo Prifti"-Novoselë, "Reshat Hoxha"-Akërne	Bashkia Vlorë DAR Vlorë	Numri i shkollave të përmirësuara me sistem ngrohjeje Qëndrueshmëria në kohë e sistemeve të përmirësuara të ngrohjes	Drejtoritë e shkollave DAR Vlorë Raporte të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve)	2019-2022	24,000,000	BV DRShSSH
1.1.3 Realizimi i veprimitave edukative individuale për zhvillimin gjuhësor të fëmijëve romë dhe egjiptianë që hasin vështirësi komunikimi në gjuhën shqipe.	DAR Shkollat me përqëndrim të lartë të fëmijëve nga pakicat Bashkia Vlorë	Numri i fëmijëve R&E të regjistruar në kopshte 3-5 vjeç. Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë të regjistruar në klasat parapërgatitore. Tregues të performancës së tyre gjuhësore	Raporte nga Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë	2019-2022	6,820,200	BV DRShSSH



1.1.4 Ofrimi i orëve suplementare në lëndë të ndryshme në përputhje me nevojat e fëmijëve romë dhe egjiptianë për të siguruar ecurinë e tyre normale.	DAR Drejtoritë e shkollave	Numri i fëmijëve R&E që marrin pjesë në orët e lira (sipas shkollës).	Informacion nga Drejtoritë e shkollave	2019-2022	12,164,400	BV DRShSsh
1.1.5 Organizimi nga shkollat 9-vjeçare të Liakatundit, Novoselës dhe Akërnisë i aktiviteteve sociale e ndërkulturore të përbashkëta me prindër dhe nxënës R&E dhe me ata që i përkasin shumicës së popullsisë, me qëllim rritjen e shkëmbimeve midis tyre.	DAR Drejtoritë e shkollave	Numri i shkollave/klasave që organizojnë aktivitete ndërkulturore. Numri i aktiviteteve të organizuara ndërkulturore. Numri i nxënësve të përfshirë në aktivitete. Numri i prindërve të përfshirë në aktivitete.	Informacion nga Drejtoritë e shkollave	2019-2022	3,000,000	BV
1.1.6 Organizimi i fushatave ndërgjegjëse me karakter informues për rreziqe dhe pasojat e trafikimit të genieve njëjzore në Akëri, Liakatund & Novoselë	DAR Drejtoritë e shkollave	Numri i fushatave të organizuara. Numri i përfutësve.	Informacion nga Drejtoritë e shkollave dhe OJF-të e Bashkisë Vlorë	2019-2022	900,000	BV DRShSsh



2. Fusha e ndërhyrjes: PUNËSIM						
2.1. Objektiv i specifik: Përmirësimi i qëndrueshëm i situatës ekonomike të familjeve të pakicave R&E nëpërmjet krijtes së mundësive për punësim						
Masa/aktiviteti	Aktorët	Treguesit e rezultateve	Burimet e të dhë-nave	Afartet	Fondet/Financimi (lekë)	Monitorim
2.1.1 Organizimi i fushatave informuese me të papunët R&E, të regjistruar pranë zyrave të punës mbi mundësitë dhe përftimet nga programet e punësimit.	Bashkia Vlorë Zyra e Punës Vlorë	Numri i fushatave të zbatuara në nivel vendor. Numri i R&E të përfshirë në fushata. Raporti ndërmjet R&E dhe të gjithë të papunëve të përfshirë në këto fushata.	Informacion dhe raporte nga ZPV	2019-2022	2,800,000	BV DRShSSh
2.1.2 Financimi i projekteve propozimeve individuale ose OSHC-ve R&E me qëllim zhvillimin e kapaciteteve, zhvillimin ekonomik dhe punësimin e pakicave R&E	OSHC-të R&E Bashkia Vlorë Shërbimi Kombëtar i Punësimit	Numri i programeve të iniciuara. Përqindja e përfutuesve R&E ndaj totalit të përfutuesve nga këto programe.	Raporte nga Z.P Vlorë dhe Bashkia Vlorë	2019-2022	6,000,000	BV DRShSSh
2.2. Objektiv Specifik. Integrimi i pakicave R&E në edukimin e përgjithshëm publik dhe trajnimet profesionale						
2.2.1 Ofrimi i kurseve profesionale për të rinjtë R&E në punë tradicionale e artizanale dhe më gjërë.	Qendra Rajonale e Formimit Profesional	Numri i kurseve të reja (në fusha artizanale) të hapura pranë Zyrës së Punës. Numri i R&E që kanë ndjekur kurse të formimit profesional në punime artizanale të ndara sipas moshës e gjinisë dhe treguesve të tjerë.	Zyra e Punës Vlorë	2019-2022	2,240,000	BV DRShSSh
2.2.2 Organizimi i fushatave informuese mbi të drejtat dhe detyrimet e R&E në fushën e punësimit.	Njësitë Administrative Novoselë, Shushicë, Qendër ZPV	Numri i fushatave të organizuara. Numri i R&E pjesëmarrës në këto fushata.	Zyra e Punës Vlorë	2019-2022	4,800,000	BV DRShSSh



3. Fusha e ndërhyrjes: Kujdesi Social						
3.1 Objektivi specifik: Rritja e kapaciteteve dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve sociale						
Masa/aktiviteti	Aktorët	Treguesit e rezultateve	Burimet e të dhënave	Afatet	Fondet/Financimi (Lekë)	Monitorim
3.1.1 Identifikimi në terren dhe regjistrimi në një databazë i romëve të pargjistruar nga zyrat e gjendjes civile në 4 NJ. A të Bashkisë Vlorë.	Bashkia Vlorë NJA-të	Numri i rasteve të identifikuara Numri i rasteve të regjistruara % e përfituesve në raport me popullatën e synuar	Informacion nga Zyra e Gjendjes Civile Vlorë OSHC-të R&E	2019- 2022	1,000,000	BV DRShSSH
3.1.2 Parandalimi dhe zgjidhja e konflikteve (dhunë në familje apo në komunitet) nëpërmjet policimit në komunitet	Komisariatet e policisë së shtetit në nivel vendor OSHC-të Drejtoritë e shkollave	Numri i konflikteve të trajtuara Numri i konflikteve potenciale të parandaluara Numri i përfituesve	Informacione nga Drejtoria Rajonale e Policisë së Shtetit Raportet e OSHC-ve	2019- 2022	800,000	BV DRShSSH
3.1.3 Zbatimi i masave lehtësuese për të ofruar ndihmë për R&E për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për të përfutur nga programet e ndihmës ekonomike.	Bashkia Vlorë OSHC-të	Numri i R&E që kanë përfutuar asistencën nga Zyra e Ndihmës ekonomike Numri i rasteve që kanë përfutur me sukses aplikimin	Drejtoria e Shërbimit Social dhe Ndihmës Ekonomike OSHC-të	2019- 2022	3,672,000	BV DRShSSH



<p>3.1.4 Organizimi i fushatave sensibilizuese me anëtarët e pakicave R&E në NJ. A Novoselë & Shushicë rreth të drejtave dhe procedurave në lidhje me skemën e NE dhe atë për personat me aftësi të kufizuar</p>	<p>Drejtoria e Shërbimit Social dhe Ndihmës Ekonomike, BV NjA-të OSHC-të</p>	<p>Numri i fushatave ndërgjegjësuere të zhvilluara çdo vit. Numri i materialeve informuese të shpërndara në zonat e banuara nga R&E. Numri i R&E që kanë marrë pjesë në këto fushata.</p>	<p>Drejtoria e Shërbimit Social dhe Ndihmës Ekonomike OSHC-të</p>	<p>2019-2022</p>	<p>2,448,000</p>	<p>BV DRShSSH</p>
<p>3.1.5 Informimi dhe dhënia e shërbimeve mbështetëse për sipërmarrësit R&E mbi zhvillimin e planeve të biznesit, kontabilitetit, procedurat ligjore dhe marketingun</p>	<p>Dhoma e Tregtisë Vlorë Bashkia Vlorë OSHC-të</p>	<p>Krijimi/larmishmëria e shërbimeve mbështetëse për biznesin R&E. Numri i sipërmarrësve R&E që kanë përfituar nga shërbimet/ trajnimet. Numri i programeve të trajnimit të zhvilluar dhe të zbatuar për R&E</p>	<p>Dhoma e Tregtisë Vlorë Bashkia Vlorë OSHC-të</p>	<p>2019-2022</p>	<p>1,000,000</p>	<p>BV DRShSSH</p>
<p>3.1.6 Monitorimi sistematik i rasteve të shfrytëzimit të punës së fëmijëve romë dhe egjiptianë</p>	<p>Inspektoriati i Punës NjMF-të OSHC-të</p>	<p>Numri i rasteve të identifikuara Numri i rasteve të monitoruara, kohëzgjatja e tyre Numri i rasteve të asistuar/referuara Numri i rasteve të larguara nga situata e shfrytëzimit/ rrugës.</p>	<p>Inspektoriati i Punës Bashkia Vlorë (NjMF-të) OSHC-të</p>	<p>2019-2022</p>	<p>816,000</p>	<p>BV DRShSSH</p>



4. Fusha e ndërhyrjes: STREHIM						
4.1 Objektivi specifik: Përmirësimi i qendrueshëm i kushteve të strehimit për pakicat R&E						
Masa/aktiviteti	Aktorët	Treguesit e rezultateve	Burimet e të dhënave	Afartet	Fondet/Financimi (lekë)	Monitorim
4.1.1 Përditësimi i vlerësimit të nevojave për strehim (ndërtim banese, rikonstruktion banese, rregullime të infrastrukturës bazë) në të gjitha njësitë administrative (4) ku banojnë pakicat R&E	NJA-të Bashkia Vlorë OSHC-të	Numri i misioneve vlerësuese në terren Raportet e vlerësimeve Numri i rasteve të identifikuar për mbështetje sipas kategorive Numri i rasteve të mbështetura Sasia e fondeve të akorduara çdo vit për ndërtimin dhe rikonstrukcion banesash të familjeve R&E	Të dhëna nga Zyra e Strehimit OSHC-të	2019-2022	816,000	BV DRShSSH
4.1.2 Rikonstruktimi i 42 banesave të banorëve romë që kanë nevojë të menjëhershme për ndërhyrje, në Njësinë Administrative Novoselë dhe Shushicë	Bashkia Vlorë	Sasia e fondeve të akorduara çdo vit për rikonstrukcion banesash të familjeve R&E Numri i ndërtesave të rikonstruktura për familjet R&E në nevojë. Numri i personave përfutues Numri i projekteve të ndërmarra në njësinë vendore	Zyra e Strehimit dhe Zyra e Planifikimit të Territorit, Bashkia Vlorë	2020-2022	25,200,000	BV DRShSSH



4.1.3 Ndërhyrja e menjëhershme për përmirësimin e kushteve të ujësjellësit (cilësia e ujit të pijshëm) dhe kanalizimeve në zonën Nj. A Qendër Vlorë dhe Nj.A Shushicë	Bashkia Vlorë	Numri total i familjeve dhe individëve përfritues Numri i familjeve dhe individëve R&E përfritues.	Plani i Zhvillimit Vlorë Bashkia Vlorë	2021-2022	200,000,00	BV DRShSSH
4.1.4 Ndërhyrja e menjëhershme për përmirësimin e infrastrukturës rrugore Rruga hyrëse në Akëri është në gjendje është e pamirëmbajtur dhe krejtësisht e amortizuar. Rruga Shushicë Llakatund me gjatësi totale 4,5 km e asfaltuar ka nevojë për rikonstruksion	Komuniteti R&E dhe popullsia shumicë & në NJ.A Novoselë & Shushicë, BV	Numri i anëtarëve/familjeve të zonës vendase që përfitojnë nga përmirësimi i infrastrukturës së rrugëve.	Bashkia Vlorë OSHC-të	2020-2022	812,500,00	BV DRShSSH
4.1.5 Trajtimi me prioritet i kërkesave të R&E për zgjidhjen e çështjeve të legalizimit përmes zbatimit të legjislacionit përkatës në NJ. A-të Novoselë dhe Shushicë	ALUIZMI Vlorë Bashkia Vlorë	Numri i rasteve të shqyrtuara Numri i shtëpive të legalizuara të R&E të cilat sigurojnë standardet përkatëse teknike dhe ligjore. Numri i kërkesave të zgjidhura në raport me totalin e kërkesave të familjeve R&E	Informacione nga Zyra e ALUIZMI Bashkia Vlorë OSHC-të	2019-2022	1,824,000	BV DRShSSH



5. Fusha e ndërhyrjes: KUJDESI SHËNDETËSOR						
5.1 Objektivi specifik: Ndërgjegjësimi i popullsisë R&E për kujdesin ndaj shëndetit dhe shërbimeve shëndetësore të ofruara						
Masa/aktiviteti	Aktorët	Treguesit e rezultateve	Burimet e të dhënave	Afatet	Fondet/Financimi (lekë)	Monitorim
5.1.1 Fushata ndërgjegjëse me R&E (të paktën 6) mbi shëndetin riprodhues, planifikimi familjar, kujdesi për shtatzëninë, fëmijët e porsalindur në NJ. A-të Shushicë, Qendër, Novoselë	Drejtoria e Shëndetit Publik Bashkia Vlorë OSHC-të	Numri i fushatava të planifikuara dhe realizuara Numri i përftuesve Numri i pjesëmarrësve R&E në programet edukative për shëndetin riprodhues.	Të dhëna nga Drejtoria e Shëndetit Publik OSHC-të	2019-2022	2,592,000	BV DRShSSH
5.1.2 Fushata ndërgjegjëse dhe edukative me R&E për mbrojtjen nga HIV/AIDS në NJ. A-të Shushicë, Qendër, Novoselë.	Drejtoria e Shëndetit Publik Bashkia Vlorë OSHC-të	Numri i fushatava të planifikuara dhe realizuara Numri i përftuesve Numri i pjesëmarrësve R&E në programet edukative mbi mbrojtjen nga HIV/AIDS.	Të dhëna nga Drejtoria e Shëndetit Publik OSHC-të	2019-2022	2,392,000	BV DRShSSH



<p>5.1.3 Organizimi i fushatave për vaksinimin e fëmijëve R&E të cilët rrezikojnë të mos kenë marrë të gjitha vaksinat</p>	<p>Drejtoria e Shëndetit Publik Bashkia Vlorë OSHC-të</p>	<p>Numri i fushatave të planifikuara dhe realizuara Numri i familjeve të depistuar Numri i fëmijëve të identifikuar me mangësi në vaksinimin Numri i përftuesve</p>	<p>Drejtoria e Shëndetit Publik Bashkia Vlorë OSHC-të</p>	<p>2019-2022</p>	<p>2,784,000</p>	<p>BV DRShSSH</p>
<p>5.1.4 Zbatimi i programeve ndërgjegjëse dhe edukative për rëndësinë dhe mënyrën e ruajtjes dhe higjienës personale dhe të zonave të banimit për R&E në NJ. A-të Shushicë, Qendër, Novoselë.</p>	<p>Drejtoria e Shëndetit Publik Bashkia Vlorë OSHC-të</p>	<p>Numri i programeve ndërgjegjëse dhe edukative për higjienën personale dhe zonave të banimit. Numri i pjesëmarrësve R&E në programet edukative mbi ruajtjen e higjienës personale dhe zonës së banimit.</p>	<p>Drejtoria e Shëndetit Publik Bashkia Vlorë OSHC-të</p>	<p>2019-2022</p>	<p>3,000,000</p>	<p>BV DRShSSH</p>



VIII. Burimet financiare

Ky kapitull trajton në mënyrë të përmbledhur burimet financiare, të nevojshme për zbatimin e **“Planit Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022, Bashkia Vlorë”**.

Kostimi i planit të veprimit u realizua mbështetur në të dhënat e ofruara nga një pjesë e drejtorive në Bashki, dokumentet e publikuara të buxhetit të bashkisë dhe institucioneve përgjegjëse. Për kostimin e planit të veprimit u përdor një metodologji e kombinuar, pasi plani përfshin disa sektorë dhe një pjesë e aktiviteteve zbatohen nga institucione të tjera. Metodologjia kryesore e përdorur është kostimi i bazuar në aktivitete. Kostimi u realizua duke u mbështetur në koston e secilit aktivitet të pasqyruar në planin e veprimit. Në llogaritjen e shpenzimeve totale u mbajt në konsideratë kohështrirja e masës, numri i aktiviteteve që do të realizohen, numri i përfituesve për aktivitete të caktuara, etj. Në disa raste u përdor dhe vlërësimi për analogji, i cili merr në konsideratë shpenzimet e bëra për aktivitete të ngjashme. Për aktivitetet që planifikohen të mbulojnë nga buxheti i qeverisë qendore u mbajtën në konsideratë kostot për njësi sipas PBA-së 2019-2021. Kostimi i Planit të Veprimit u realizua gjithashtu bazuar në praktikën e planifikimit buxhetor dhe metodologjinë e hartimit të buxhetit afatmesëm.

Kostoja e përgjithshme e përlogaritur për zbatimin e masave, nga të gjitha burimet e financimit, është rreth 1 miliard e 123 milionë lekë ose afërsisht 8.9 milionë euro¹⁸. Alokimi i fondeve për periudhën 2019-2022 u programua duke mbajtur në konsideratë tavanet e projektbuxhetit afatmesëm (PBA 2020-2022). Burimet financiare nga buxheti i shtetit mbulojnë rreth 4.0% të koston së planit të veprimit, përkatësisht rreth 45.1 milionë lekë. Ndërsa burimet e financimit të angazhuara nga bashkia mbulojnë 41.3% të koston së planit të veprimit ose 464.6 milionë lekë.

Tabela 8. 1 paraqet buxhetin në vite sipas objektivave strategjike. Rreth 92.6% e shpenzimeve nevojiten për objektivin strategjik 4 “Përmirësimi i qëndrueshëm i kushteve të strehimit për popullsinë Rome”.

18 Kursi këmbimit 1Euro=125 lekë



Tabela 1: Buxheti sipas objektivave strategjik për periudhën 2019-2022

Përkrahimi	Buxheti 2019-2022					TOTALI
	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	TOTALI	
OBJEKTIVAT						
Përmirësimi i situatës arsimore të romëve dhe egjiptianëve në Bashkinë Vlorë	6,463,910.00	13,563,910.00	13,563,910.00	13,563,910.00	47,155,640.00	
Fuqizimi i pakicave rome dhe egjiptiane përmes rritjes së aksesit në tregun e punës, programeve të trajnimit dhe skemave të mbrojtjes sociale	3,960,000.00	3,960,000.00	3,960,000.00	3,960,000.00	15,840,000.00	
Sigurimi i përfshirjes sociale dhe rritje e aksesit në institucionet publike	2,434,000.00	2,434,000.00	2,434,000.00	2,434,000.00	9,736,000.00	
Përmirësimi i qëndrueshëm i kushteve të strehimit dhe infrastrukturës	660,000.00	309,060,000.00	409,060,000.00	321,560,000.00	1,040,340,000.00	
Përmirësimi i qëndrueshëm i kushteve shëndetësore të romëve dhe egjiptianëve në Bashkinë Vlorë	2,692,000.00	2,692,000.00	2,692,000.00	2,692,000.00	10,768,000.00	
TOTAL (1+2+3+4+5)	16,209,910.00	331,709,910.00	431,709,910.00	344,209,910.00	1,123,839,640.00	



Tabela 8.2 paraqet shpenzimet sipas burimeve të financimit dhe hendekun financiar për secilin nga objektivat specifike. Bashkia ka planifikuar të përfitojë nga fondet e buxhetit të shtetit për strehimin përmes aplikimeve në programin e strehimit. Shpenzimet për këto projekte nuk janë konsideruar si hendek financiar. Hendeku financiar i pambuluar nga të gjitha burimet e financimit është 54.4%. Pjesa më e madhe e hendekut financiar është për objektivin 4, ku përfshihen aktivitetet për përmirësimin e infrastrukturës. Pjesa tjetër e hendekut financiar mendohet të mbulohet nga donatorë të ndryshëm dhe organizata të shoqërisë civile.



Tabela 8.2: Shpenzimet sipas burimeve të financimit

Përshkrimi	FINANCUAR NGA					Nevojat për Fonde LEKË
	Bashkia	Qeveria	Donatorët	Të tjerë	Totali	
OBJEKTIVAT						
Përmirësimi i situatës arsimore të romëve dhe egjiptianëve në Bashkinë Vlorë	7,091,240.00	12,164,400.00	0.00	0.00	19,255,640.00	27,900,000.00
Fuqizimi i pakicave rome dhe egjiptiane përmes rritjes së aksesit në tregun e punës, programeve të trajnitimit dhe skemave të mbrojtjes sociale	0.00	5,040,000.00	0.00	0.00	5,040,000.00	10,800,000.00
Sigurimi i përfshirjes sociale dhe rritje e aksesit në institucionet publike	7,936,000.00	0.00	0.00	1,000,000.00	8,936,000.00	800,000.00
Përmirësimi i qëndrueshëm i kushteve të strehimit dhe infrastrukturës	449,606,000.00	20,160,000.00	0.00	1,824,000.00	471,590,000.00	568,750,000.00
Përmirësimi i qëndrueshëm i kushteve shëndetsore të romëve dhe egjiptianëve në Bashkinë Vlorë	0.00	7,768,000.00	0.00	0.00	7,768,000.00	3,000,000.00
TOTAL (1+2+3+4+5)	464,633,240.00	45,132,400.00	0.00	2,824,000.00	512,589,640.00	611,250,000.00



IX. Monitorimi dhe vlerësimi

Plani Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane është një dokument politik e zhvillimi i Bashkisë Vlorë për komunitetet e synuara, cikli i të cilit nuk duhet të përfundojë vetëm me miratimin e tij nga Kryetari dhe Këshilli Bashkiak. Zbatimi i masave dhe monitorimi i rregullt i tyre, në intervale të caktuara kohore, grumbullimi i të dhënave të treguesve të matshëm, vlerësimi i impaktit në përmirësimin e aksesit në shërbimet publike të ofruara për komunitetet, dhe publikimi i rezultateve të zbatimit të masave, janë përgjegjësi institucionale e bashkisë dhe bazohen në parimet e besueshmërisë së qeverisjes vendore, mosdiskriminimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve dhe informimit publik.

Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit do të ushqejnë orientimin e politikave të reja dhe shpërndarjen e burimeve në nivel vendor në kuadër të planifikimit strategjik dhe procesit të vendimmarrjes vendore. Gjithashtu raportet e monitorimit do të ofrojnë informacion të vlefshëm dhe cilësor në kuadër të raportimit të sistemit ROMALB, që kryhet dy herë në vit pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në nivel të lartë, raporti i monitorimit do të lehtësojë vendimmarrjen e informuar të Grupit Institucional të Punës në nivel vendor, i cili do të jetë përgjegjës për monitorimin e progresit të të gjitha planeve të zhvillimit të miratuara nga Bashkia, si Planin e Përgjithshëm Vendor, procesin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe të buxhetit. Monitorimi i progresit të zbatimit të objektivave dhe masave/aktiviteteve të Planit për integrimin e R&E të Bashkisë do të paraqitet në mënyrë periodike (të paktën 1 -2 herë në vit).

Në nivel operacional, për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit për integrimin e R&E në Bashkinë Vlorë, struktura përgjegjëse do të jetë Drejtoria e Shërbimit Social. Drejtoria e Shërbimit Social është përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore nga të gjitha strukturat e Bashkisë sipas sektorëve përkatës si dhe nga të gjitha institucionet e tjera publike. Drejtoria e Shërbimit Social në Bashki ka rol koordinues dhe bashkërendues mbi ecurinë e zbatimit të planit. Plani i Veprimit parashikon publikimin e progres raporteve vjetore dhe mbështetjen për raportet monitoruese të shoqërisë civile.

Sfida për një funksionim më të plotë të kuadrit monitorues mbetet rritja e kapaciteteve të vetë stafit të bashkisë, përmirësimi i shkallës së përgjegjshmërisë të strukturave të tjera të bashkisë si dhe bashkëpunimi dhe ndërveprimi me strukturat e tjera të nivelit vendor në varësi të institucioneve qendrore.

Procesi i vetë-deklarimit si romë ose egjiptianë nuk është i standardizuar dhe disa struktura në nivel vendor hezitojnë të mbledhin këto të dhëna nga frika se mos dhunojnë të drejtat e privatësisë dhe të drejtën e vetë-deklarimit, që sanksionohet



me ligj. Nevojitet ngritja e kapaciteteve për të garantuar që të gjitha zyrat publike përkatëse të mund të mbledhin të dhënat e nevojshme për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit, duke mbrojtur njëkohësisht të drejtat e privatësisë së romëve dhe egjiptianëve. Mungojnë veçanërisht të dhënat mbi gjendjen e egjiptianëve.

Në nivel të sektorëve prioritarë dhe të objektivave strategjike, monitorimi do të kryhet përmes mekanizmit të vlerësimit bazuar në rezultate nëpërmjet indikatorëve të matshëm, si dhe vëzhgimit mbi cilësinë dhe aksesueshmërinë në shërbimet publike të romëve dhe egjiptianëve. Këto vëzhgime vjetore duhet të ndërmerren nga bashkia në bashkëpunim me organizata komunitare dhe OSHC-të. Rezultatet e vëzhgimeve duhet të publikohen në faqen e internetit të Bashkisë dhe sistemin ROMALB.

Në kushtet e burimeve të kufizuara të stafit të bashkisë dhe kapaciteteve profesionale të kufizuara, monitorimi i planit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve mund të mbështetet me ekspertizë të jashtme nga projekte të agjencive donatore, të paktën për vitin e parë të cilat në procesin e realizimit të monitorimit do të ndihmojnë në zhvillimin e njohurive dhe përmirësimin e kapaciteteve të administratës vendore në drejtim të monitorimit dhe raportimit.

Bashkia përditëson rregullisht sistemin elektronik online "ROMALB" për regjistrimin dhe rifreskimin e të dhënave për treguesit e Planit të Veprimit NAPIRE¹⁹, 2016-2020, dhe MSHPS ofron asistencë teknike dhe trajnime për përdoruesit e sistemit në Bashki. Baza kryesore e kuadrit monitorues të Planit për integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane në nivel vendor, do të jetë seti i indikatorëve të monitorimit sipas tabelës në shtojca.

19 NAPIRE, 2016-2020



X. Shtojcat

Shtojca X.1 Monitorimi i Planit Vendor për Bashkinë Vlorë

Koordinimi, Monitorimi dhe Vlerësimi i Planit të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në nivel vendor						
Masa/Aktiviteti	Aktorët	Treguesit e rezultateve	Burimet e të dhënave	Afatet	Fondet/Financimi	Monitorimi
Objektivi 1: Monitorimi i zbatimit të masave dhe treguesve të planit të veprimit me të gjitha institucionet në nivel vendor për të reduktuar pabarazinë sociale – ekonomike të R&E dhe për të rritur aksesin në shërbimet publike.						
Treguesi: Publikimi i raportit të progresit çdo vit.						
1.1 Krijimi i një baze të dhënash për të mbledhur informacion mbi treguesit e Planit të Veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në nivel vendor (përfshirë tregues të planit vendor që nuk përmbahen në sistemin ROMALB)	Bashkia/ Drejtoria e Shërbimit Social	Bazë të dhënash e krijuar me treguesit e masave dhe tregues të tjerë që nuk përmbahen në sistemin ROMALB.	Raportim i DSHS (Bashkia)	Çdo vit (2019-2022)	Fond i Bashkisë (pa kosto shtesë)	Bashkia / DSHS
1.2. Komunikimi me të gjitha institucionet publike dhe aktorë të tjerë në nivel vendor për të siguruar informacion të përditësuar (sasior dhe cilësor) sipas sektorëve prioritarë të Planit të Veprimit lidhur me raportimin e progresit.	Bashkia/ DSHS	-	Raportim nga Bashkia/DSHC	Çdo vit (2019-2022)	Fond i Bashkisë (pa kosto shtesë)	Bashkia / DSHS





1.3 Hartimi i raportit të progresit dhe publikimi i tij (online në website të bashkisë) lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në nivel vendor dhe vlerësimin e treguesve.	Bashkia/ Grupi punës /DHS	Raporti i progresit publikuar	Raporti i Progresit /seti i treguesve përditësuar	Çdo Janar (2020-2022)	Fondi Bashkisë / asistencë me ekspertë të jashtëm	Bashkia / DSHS, Raporti vjetor i grupit të monitorimit dhe ekspertit i jashtëm
1.4 Organizimi i takimeve (të paktën) çdo gjashtë muaj me lehtësuesit për pakicat R&E dhe OSHC-të për të dhënë përditësime për zbatimin e Planit të Veprimit dhe për të adresuar çështje kritike	Bashkia/ Grupi punës/ DHS/ qendra ko-munitare/ lehtësuesit (pikat e kontaktit)	Numri i takimeve, list-prezenca, agjenda e takimeve	Evidenca të takimeve	Çdo 6-mujor (2019-2022)	Fondi Bashkisë (pa kosto shtesë)	Bashkia / DSHS / qendra ko-munitare/ lehtësuesi
1.5 Përditësimi i sistemit të monitorimit dhe raportimit online (ROMALB) me të dhëna të reja nga përdoruesit në nivele të ndryshme	Bashkia/ DHS (koordinatori per sistemin ROMALB)	Seti i treguesve përditësuar	Treguesit e përditësuar	Çdo vit (2019-2022)	Fondi Bashkisë (pa kosto shtesë)	Bashkia / DSHS



Shtojca X.2

Figurë 5. Konsultime publike mbi Draft Planin Vendor



Figurë 6: Orientim drejt praktikave profesionale



Figurë 7: Orientim drejt punësimit



Shtojca X.3 Task-Forca Bashkiake në Vlorë

Grupi Institucional i Punës

Emer Mbiemer	Institucioni	Pozicioni i Punës	Email
Fabiola Delilaj	Bashkia Vlorë	Focal Point	delilaj.fabiola@gmail.com
Rajmonda Sinoimeri	Bashkia Vlorë	Specialiste arsimi	rsinoimeri@yahoo.com
Drita Mustafaraj	Bashkia Vlorë	Specialiste Strehimi	drita_mustafaraj@yahoo.com
Rezarta Andoni	Bashkia Vlorë	Zyra e Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje	r-andoni@hotmail.com
Irena Stasa	Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror	Drejtores	irena.cakrani@yahoo.com
Gjinovefa Xhorda	Drejtoria Rajonale e Punësimit	Specialiste	vefi@live.com
Desilda Caci	Bashkia Vlorë	Zyra e informacionit	informacioni@vlora.gov.al
Mariana Cani	Drejtoria Rajonale e Punësimit	Drejtores	cani.mariana@yahoo.com

Grupi Komunitar i Veprimt

Beshire Selimi		Lavdie Hamza	
Ganimete Kalemi		Qani Kalemi	
Florian Kamberi		Fajton Kamberi	
Muhameti Mile		Romeo Mile	
Mariglen Mile		Marcelino Latifaj	
Dashnor Latifaj		Vera Tufa	
Rozina Kormuzi			



Shtojca X.4 Vendim i Këshillit Bashkiak Vlorë



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
KËSHILLI I BASHKISË VLORË

Nr. 1505/prot.
11

Vlorë, më 02.03 2020

VENDIM

Nr. 15, datë 27.02, 2020

“PER MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË INTEGRIMIT TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN PËR BASHKINË VLORË”

Këshilli i Bashkisë Vlorë mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17/12/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjin Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Ligjin Nr. 96/2017” Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 22/2018. “Për strehimin social”, Vendim Nr. Date 18.02. 2018 I Keshillit Bashkiak Vlore “Per miratimin e memorandumit e mirekuptimit ne kuader te projektit “; pasi morri në shqyrtim materialin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Vlorë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë;

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin Vendor të Integrimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian për Bashkinë Vlorë
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Koordinatorin i Projektit ROMACTED në Bashkinë Vlorë, Administratorët e Njësive Administrative, Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social, Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Sektori i Arsimit në Bashki.
3. Ky Vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETARE

Migena Balla

Konceptoi: *Fabiola Deliaj*, Këshilltare në Kabinatën e Kryetarit.



Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, Tet: 033421201; Fax: 033421201: www.vlor.gov.al, e-mail: info@vlor.gov.al



ROMANACTED

*Promovimi i qeverisjes së
mirë dhe fuqizimit Rom
në nivelin vendor*

SQI

Këshilli i Evropës është organizata udhëheqëse e kontinentit për të drejtat e njeriut. Përbëhet nga 47 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës e kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i projektuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

www.coe.int

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të bashkojnë njohuritë, burimet dhe fatet e tyre. Bashkarisht, kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qendrueshëm krahas ruajtjes së diversitetit kulturor, tolerancës dhe lirive individuale. Bashkimi Evropian angazhohet në ndarjen e arritjeve dhe vlerave me vendet dhe njerëzit përtej kufinjve të vet.

www.europa.eu

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës